

- administrimit dhe mbrojtjes sëtokës.
2. Krijimin, administrimin, përditesimin (update) dhe bërjen e kopjes rezervë (back up) të arkivit elektronik të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës të Qarkut Gjirokastrë.
 3. Mbajtjen, inventarizimin, administrimin dhe arkivimin e regjistrave dhe hartave kadastrave për;
 4. Dhënien e të dhënave kadastrale personave fizikë/juridikë në bazë të dokumentacionit që disponon kundrejt tarifave të miratuara nga Ministria përkatëse;
 5. Mbajtjen dhe ruajtjen e arkivit me dokumentacionin themelor kadastral, si librat e tokës, librat e ngastrave, planimetritë, hartat kadastrale, topografike dhe dokumente të tjera ekzistuese të arkivit të kadastrës;
 6. Mbajtjen, inventarizimin, administrimin dhe arkivimin e akteve të organeve shtetërore përgjegjëse për kalimet dhe ndryshimet në gjendjen e tokave, ndryshimet në kategoritë e tokës, si dhe përmbledhëseve që pasqyrojnë çdo vit ndryshimet në përdorimin e tokës;
 7. Mbajtjen, inventarizimin, administrimin dhe arkivimin e përmbledhëseve që pasqyrojnë, çdo vit, ndryshimet e treguesve, fizikë e kimikë, të tokës si rezultat i kryerjes së analizave;
 8. Mbajtjen, inventarizimin, administrimin dhe arkivimin e gjithë dokumentacionit që ka të bëjë me informacionet me zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për ndryshimet e pronësisë dhe bashkimet e parcelave.
 9. Kryerjen e çdo detyre tjetër të parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore ose të kërkuar nga Drejtori/Përgjegjësi ose Kryetari i Këshillit të Qarkut

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në

1 LËVIZJA PARALELE

të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

- a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit "Mirë" apo "Shumë mirë";
- ç) Të plotësojë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si më poshtë:

1. Te zoterojë diplome të nivelit minimal "Bachelor" në një nga fushat Agronom/ Gjeodet/ Gjeograf/ Shkencat Ekonomike.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, dokumentat si më poshtë:

Adresa: Rruga "Ismail Kadare", Tel: +355842563721, email: keshilli.qarkutgjirokaster@yahoo.com

a-Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

a- <http://www.dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44-ndhezim%219-ndhezime-dokumenta>

b-Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);

c-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e-Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;

g-Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

h-Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

i-Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, brenda datës 01.03.2026

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 02.03.2026 pas verifikimit paraprak të kandidatëve Këshilli i Qarkut Gjirokastrë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” të faqja zyrtare e internetit të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë si dhe në stenden e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, për shkak të moskualifikimit.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Njohuritë mbi Ligjin Nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

nënligjore dalë në zbatim të tij

2. Ligjin nr. 8752, datë 26.03.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës, i ndryshuar";
3. V.K.M Nr.121, datë 17.02.2011 “Për mënyrën e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtje së tokës në Komuna/Bashki”
4. Ligjin Nr. 9244, datë 17.06.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatet do të vlerësohen për pervojën me 20 pike, 10 pike për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe 10 pike për çertifikimet pozitive. Totali i pikeve për këtë vlerësim është 40 pike.

Kandidatet gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;

Adresa: Rruga "Ismail Kadare", Tel: +355842563721, email: keshilli.qarkutgjirokaster@yahoo.com

- b- Eksperiencen e tyre te meparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmerine e tyre per karrierren.

Totali i pikeve per kete vleresim eshte 60 pike.

Ne perfundimin te vleresimit perzgjidhet kantidati, i cili renditet i pari nder kantidatet qe kane mare te pakten 70 pike.

Me shume detaje ne lidhje me vleresimin me pike, metodologjine e shperndarjes se pikeve, menyren e llogaritjes se rezultatit perfundimtar i gjeni ne Udhezimin nr. 2 dt. 27.03.2015 te Departamentit te Administrates Publike "www.dap.gov.al"

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë do të shpallë fituesin në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" te faqja e internetit e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë dhe në stenden e Këshillit të Qarkut.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për shpalljen e fituesit.

2 PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se pozicioni renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende është vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Këtë Informacion do ta merrni pranë Këshillit të Qarkut, duke filluar nga data 02.03.2026

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NE SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë shërbimit civil të cilët plotësojnë kërkesat e nenit 21, Kreut IV, të ligjit nr. 152/2013 i ndryshuar .

Kushtet qe duhet te plotesoje kandidati ne proceduren e pranimit ne sherbimin civil jane :

- a) Te jete shtetas shqiptare;
- b) Te kete zotesi per te vepruar ;
- c) Te zoteroje gjuhen shqipe , te shkruar dhe te folur ;
- d) Te jete ne kushte shendetsore qe lejojne te kyeje detyren teknike perkatese;
- e) Te mos jete i denuar me vendim te formes se prere per te kryerjen e nje krimi apo per kryerjen e nje kundravajtje penale me dashje;
- f) Ndaj tij te mos jete mare masa disiplinore e largimit nga sherbimi civil , qe nuk eshte shuar sipas ligjit 152/2013 "Per nepunesin civil " i ndryshuar .

Kandidati duhet te plotesoje kerkesat e posacme si vijon :

- a. Te zoterojë diplome të nivelit "Bachelor" në një nga fushat Agronom/ Gjeodet/ Gjeograf/ Shkencat ekonomike.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://ec0.dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/219-udhezime-dokumenta>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore / Vërtetim të gjendjes gjyqësore.
- h- Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhet pranë Këshillit të Qarkut Gjirokastrë.

Dokumentat e aplikimit duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 06.03.2026 në adresën: Rruga "Ismail Kadare", Këshilli i Qarkut Gjirokastrë.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 09.03.2026, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" te faqja e internetit e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë si dhe te stenda e Këshillit të Qarkut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

1. Njohuritë mbi Ligjin Nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar) si dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij
2. Ligjin nr. 8752, datë 26.03.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës, i ndryshuar";
3. V.K.M Nr.121, datë 17.02.2022 "Për mënyrën e yshtimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtje së

Adresa: Rruga "Ismail Kadare", Tel: +355842563721, email: keshilli.qarkutgjirokaster@yahoo.com

tokës në Komuna/Bashki”

4. Ligjin Nr. 9244, datë 17.06.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Totali i pikeve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatesisht:

- a- deri në 60 pikë për vlerësimin me shkrim
- b- Intervisten e strukturuar me gojë që konstiton në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pike.
- c- Jetëshkrimin, që konstiton në vlerësimin e arsimit të parësor dhe të trajnimeve, të lidhura me fushën perkatese, deri në 15 pike.

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqja zyrtare të internetit të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë si dhe në stenden e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet.

Për sqarime të mëtejshme mund të na kontaktoni në adresën e e-mail keshilli.qarkutgjirokaster@yahoo.com ose në adresën: Rruga “Ismail Kadare”, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë



Adresa: Rruga “Ismail Kadare”, Tel: +355842563721, email: keshilli.qarkutgjirokaster@yahoo.com